



*Dokument informues mbi
zbatimin e Politikës
Macroprudenciale në Shqipëri*

Publikuar në Maj 2021

| Përmbajtja: | | Faqe: |
|-------------|--|-------|
| I. | Përmbledhje | 3 |
| II. | Stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale | 6 |
| 2.1 | Hyrje | 6 |
| 2.2 | Roli i politikës makroprudenciale dhe natyra e rrezikut sistemik | 6 |
| 2.3 | Roli kryesor i bankës qendrore në zbatimin e politikës makroprudenciale | 7 |
| 2.4 | Ndërveprimi mes politikës makroprudenciale dhe politikave të tjera ekonomike | 8 |
| 2.4.1 | - Ndërveprimi me politikën monetare | 8 |
| 2.4.2 | - Ndërveprimi me politikën mikroprudenciale | 9 |
| 2.4.3 | - Ndërveprimi me kuadrin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme | 10 |
| 2.4.4 | - Ndërveprimi me politikën fiskale | 10 |
| 2.4.5 | - Ndërveprimi me politikën e konkurrencës | 10 |
| III. | Korniza institucionale e politikës makroprudenciale në Shqipëri | 11 |
| 3.1 | Roli i Bankës së Shqipërisë në zbatimin e politikës makroprudenciale | 11 |
| 3.2 | Autoritetet e tjera shqiptare që kontribuojnë në stabilitetin financiar | 12 |
| 3.3 | Bashkëpunimi ndërkufitar | 12 |
| 3.4 | Procesi i brendshëm i vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë | 13 |
| IV. | Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut sistemik | 14 |
| 4.1 | Vlerësimi sasior: cilësia e të dhënave | 14 |
| 4.2 | Vlerësimi cilësor | 15 |
| 4.3 | Roli i provave (testeve) të rezistencës në kornizën makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë | 15 |
| 4.4 | Harta e rreziqeve makroprudenciale (<i>heatmap</i>) e Bankës së Shqipërisë | 16 |
| 4.5 | Burimet e reja të rrezikut sistemik: <i>fintech</i> dhe ndryshimi i klimës | 19 |
| V. | Zbatimi i politikës makroprudenciale në Shqipëri | 20 |
| 5.1 | Strategjia e politikës makroprudenciale | 20 |
| 5.2 | Objektivat e ndërmjetëm dhe instrumentet e politikës | 21 |
| 5.3 | Instrumentet makroprudencialë të zbatuar nga Banka e Shqipërisë dhe puna e së ardhmes | 23 |
| 5.3.1 | - Zbatimi i shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) | 24 |
| 5.3.2 | - Zbatimi i shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST) | 25 |
| 5.3.3 | - Zbatimi i shtesës së kapitalit për rrezikun sistemik (STRUK) | 25 |
| 5.3.4 | - Raporti i mbulimit me likuiditet (RML) | 26 |
| 5.4 | Kombinimi i instrumenteve të ndryshëm makroprudencialë | 26 |
| 5.5 | Puna e së ardhmes | 27 |
| 5.6 | Ndërveprimi i politikave në Bankën e Shqipërisë | 27 |
| VI. | Komunikimi dhe llogaridhënia | 28 |

I. Përmbledhje

Ky dokument ka për qëllim të përshkruajë dhe të aktualizojë statusin e zbatimit të politikës makroprudenciale në Shqipëri.

Politika makroprudenciale i kushtohet analizës dhe parandalimit të rrezikut sistemik, në dimensionin ciklik dhe në atë strukturor, si dhe përforcimit të rezistencës së institucioneve financiare. Fusha e zbatimit të politikës makroprudenciale përfshin të gjithë sistemin financiar dhe ndërveprimin e tij me ekonominë reale. Në sistemet financiare që mbizoterojnë nga bankat, fokusi është në aktivitetin e sektorit bankar. Për të arritur objektivin përfundimtar të stabilitetit financiar, politika makroprudenciale ka qëllim të parandalojë disa rreziqe kyçe, të identifikuar si objektivat e ndërmjetëm. Në Bashkimin Evropian, objektivat e ndërmjetëm janë identifikuar nga Bordi Evropian për Rrezikun Sistemik (BERRS) dhe përfshijnë rreziqet që dalin nga rritja e tepruar e kreditimit dhe e huamarrjes, përqëndrimi i ekspozimeve, pamjaftueshmëria e aktiveve likuide dhe mungesa e likuiditetit të tregut, si edhe nga kontributi në rrezikun sistemik i institucioneve financiare me rëndësi sistematike. Për të adresuar këto rreziqe përdoren disa instrumente, zakonisht të natyrës prudenciale, për të përforcuar nivelet e kapitalit, për të përmirësuar financimin dhe për të garantuar cilësinë e ekspozimeve të institucioneve financiare.

Në përgjithësi, banka qendrore luan një rol aktiv në zbatimin e politikës makroprudenciale. Kjo reflekton nga njëra anë, funksionin e saj ekzekutiv në lidhje me zbatimin e pavarur të politikës monetare, promovimin e sistemeve të pagesave, emetimin e kartëmonedhave dhe administrimin e rezervës valutore, dhe nga ana tjetër aftësitë teknike për të mbledhur, modeluar dhe analizuar të dhënat e lidhura ekonomike. Ekspertiza e saj kërkohet gjerësisht edhe kur autoriteti makroprudencial operon ligjërisht jashtë bankës qendrore. Kur banka qendrore është edhe mbikëqyrësi mikroprudencial i bankave (e ndoshta edhe i institucioneve financiare jobanka) shtohen arësyet për t'i veshur asaj kompetenca makroprudenciale. Megjithatë kompetencat e shtuara shoqërohen me përgjegjësi më të mëdha, të cilat arrihen përmes niveleve të ngritura të transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë rast, duhet të ekzistojnë procedura për të përcaktuar se si banka qendrore vë në zbatim politikën e saj për të përfituar nga sinergjitë ekzistuese dhe për të zbutur konfliktet e mundshme mes fushave politike të ndryshme.

Korniza ligjore e përkufizon Bankën e Shqipërisë si bankën qendrore në vend, që zbaton politikën monetare në përmbushje të objektivit të saj kryesor, atij të stabilitetit të çmimeve dhe, në përmbushje të objektivave të tjera vepron si autoriteti mbikëqyrës, rregullator dhe i ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat që operojnë në Shqipëri, promovon funksionimin e sistemeve të pagesave dhe vendos rregullat për parandalimin dhe administrimin e rrezikut sistemik. Në bazë të këtyre funksioneve dhe duke qenë se sektori bankar mbizotëron në aktivitetin e përgjithshëm të sistemit financiar, Banka e Shqipërisë e gjen veten në pozicionin e natyrshëm të autoritetit publik që udhëheq zbatueshmërinë e politikës makroprudenciale. Gjatë kryerjes së kësaj detyre të rëndësishme, ashtu si edhe me politikën e tjera, Banka e Shqipërisë zbaton parimin e pavarësisë, duke njohur njëkohësisht rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies, ashtu si edhe bashkëpunimin me autoritetet përkatëse, lokale dhe të huaja, për të zbutur rreziqet sistematike dhe për të mbrojtur stabilitetin financiar. Brenda vendit, autoritetet e tjera që kontribuojnë në

stabilitetin financiar janë: Qeveria Shqiptare (ministria që administron financat publike), Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me këto autoritete përmes Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) ose duke kërkuar bashkëpunimin dypalësh.

Zbatimi i politikës makroprudenciale në Bankën e Shqipërisë është instrument i rëndësishëm i funksionit të stabilitetit financiar. Procesi ndjek një cikël që ofron identifikimin dhe analizimin e rreziqeve sistemike, përzgjedhjen dhe kalibrimin e instrumenteve makroprudencialë, zbatimin dhe komunikimin e politikës dhe rrjedhimisht vlerësimin e ndikimit të instrumenteve dhe, kur është e domosdoshme, rishikimin e masave që po zbatohen. Rreziqet sistemike klasifikohen në përputhje me objektivat e ndërmjetëm që përzgjidhen nga BERRS-i dhe ecuria e rreziqeve vlerësohet nëpërmjet disa treguesve të identifikuar. Analiza e rreziqeve sistemike mbështetet nga lehtësitë për mbledhjen e të dhënave (raportimet e rregullta, vrojtimit, qarkullimi i të dhënave brenda institucionit) dhe procese të tjera për monitorimin dhe analizimin e tyre (provat e rezistencës, *heatmap*-i, bashkëpunimi me departamentet e tjera, gjykimi i ekspertëve). Në Komitetin Këshillimor të Stabilitetit Financiar (KKSF) diskutohet për mënyrën se si instrumenti i propozuar makroprudencial mund të arrijë objektivat e tij (cilat janë kanalet e transmetimit) dhe se si ai mund të ndikojë në politikat e tjera ekonomike të Bankës së Shqipërisë. Në një fazë të caktuar, diskutimet përfshijnë industrinë bankare dhe, nëse është e nevojshme, autoritetet shtetërore përkatëse. Instrumenti i përzgjedhur makroprudencial përgatitet më pas për t'u vënë në zbatim dhe shpallet publikisht me një vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, ose me një vendim të Guvernatorit siç është deleguar nga Këshilli Mbikëqyrës. Me t'u futur në zbatim, Banka e Shqipërisë vijon të monitorojë ndikimin e instrumentit makroprudencial të përzgjedhur mbi objektivat e ndërmjetëm që kërkon të përmbushë. Procesi i sipërcituar përsëritet nëse politika makroprudenciale kërkon veprime të mëtejshme.

Pas miratimit të Strategjisë për Politikën Makroprudenciale të vitit 2018 dhe analizës së rregullt të rrezikut sistematik, Banka e Shqipërisë ka përgatitur kornizën rregullatore për zbatimin e disa instrumenteve makroprudencialë. Këtu përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit për të rritur rezistencën e bankave përkundrejt rreziqeve sistemike ciklike dhe strukturore, por edhe masat për të ulur rreziqet që shoqërojnë nivelet e larta të euroizimit. Banka e Shqipërisë ka vënë në zbatim shtesën kundërciklike të kapitalit (KUNC), shtesën konservuese të kapitalit (KONS) dhe shtesën e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST) dhe po punon për të operacionalizuar shtesën e kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK). Në lidhje me rritjen e përdorimit të monedhës vendase (deeuroizimin) janë marrë masa rregullatore për të kufizuar madhësinë e detyrimeve në monedhë të huaj, për të rritur kërkesat minimale për aktivet likuide në monedhë të huaj, dhe për të përmirësuar vetëdijen e humarrësve të pambuluar¹ ndaj rrezikut të huave në monedhë të huaj. Banka e Shqipërisë ka miratuar gjithashtu kornizën rregullatore për zbatimin e Raportit të Mbulimit me Likuiditet me qëllim që të përafrojë standardet e administrimit të rrezikut të likuiditetit me ato të Bashkimit Evropian.

¹ Ky është rasti kur monedha e huasë është e ndryshme nga monedha në të cilën huamarrësi gjeneron të ardhurat kryesore.

Zhvillimet në tregjet financiare dhe në ekonominë reale kërkojnë vëmendje të pandërprerë për të identifikuar dobësitë dhe rreziqet. Ndërlidhja mes segmenteve të ndryshëm të sistemit financiar, zhvillimet në tregjet e aktiveve jofinanciare dhe ndërveprimi i sistemit financiar me ekonominë reale janë fusha ku mund të ekzistojnë dobësi dhe mund të shfaqen rreziqe. Me rol në politikën makroprudenciale, Banka e Shqipërisë dëshiron të zgjerojë kapacitetet e saj për të mbledhur të dhëna të dobishme dhe aktuale nga këto fusha, në mënyrë që të zhvillojë mjete për vlerësimin e rrezikut dhe të konceptojë përgjigje efektive makroprudenciale. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë po mbështet bashkëpunimin ndërinstitucional dhe po bën punë përgatitore për përvijimin e kornizës së instrumenteve makroprudencialë të bazuar te huamarrësit, siç janë kufijtë 'vlere e huase / vlerë e prone' dhe 'pagesa e borxhit / e ardhura e huamarresit'. Si përfundim, komunikimi me grupet përkatëse të interesit është çelësi për të konceptuar një qasje mbikëqyrëse të përshtatshme që njeh dobietë dhe kupton rreziqet që burojnë nga zhvillimet e reja të lidhura me *Fintech* dhe ndryshimet klimatike.

Banka e Shqipërisë konsideron se komunikimi rreth konceptimit dhe zbatimit të politikave të saj makroprudenciale, krahas përmbushjes së objektivit të llogaridhënies, kontribuojnë për të njoftuar publikun rreth vlerësimit të rreziqeve financiare. Këto komunikime kanë forcë për të ndikuar sjelljen e pjesëmarrëve të tregut dhe për të përmirësuar disiplinën e tregut. Banka e Shqipërisë synon të arrijë nivelin më të lartë të transparencës për të komunikuar politikën saj makroprudenciale. Ky dokument kontribuon në listën e publikimeve dhe mjeteve të tjera që Banka e Shqipërisë përdor për të përmbushur këtë synim.

Ky dokument i politikës makroprudenciale është organizuar si në vijim: *pjesa II* diskuton standardet më të mira ndërkombëtare për një kornizë institucionale në zbatimin e politikës makroprudenciale dhe rëndësinë e bashkërendimit mes politikave të ndryshme; *pjesa III* përshkruan kornizën institucionale të politikës makroprudenciale në Shqipëri, rolin që luajnë Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera shtetërore, dhe procesin e brendshëm vendimmarrës të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e politikës makroprudenciale; *pjesa IV* fokusohet tek mjetet dhe proceset që Banka e Shqipërisë përdor për të grumbulluar të dhëna dhe për të vlerësuar rrezikun sistematik, dhe se si ato mund të zgjerohen për të monitoruar dhe adresuar rreziqet e reja; *pjesa V* përshkruan mënyrën se si Banka e Shqipërisë ka vënë në zbatim politikën e saj makroprudenciale duke përdorur instrumente të shumëllojshme makroprudencialë, në harmonizim me politikat e tjera financiare; dhe *pjesa VI* përfundon duke ofruar më tepër detaje për mënyrën se si Banka e Shqipërisë komunikon rreth politikës së saj makroprudenciale.

II. Stabiliteti Financiar dhe Politika Makroprudenciale

2.1 Hyrje

Kriza financiare globale e vitit 2008 theksoi rëndësinë e politikës makroprudenciale në parandalimin e rreziqeve sistemike dhe në mbrojtjen e stabilitetit financiar. Përvoja ndërkombëtare e deritanishme shfaq rolin kyç të bankës qendrore në zbatimin e këtyre politikave, për shkak të sinergjive të krijuara nga funksionet që kryen dhe nivelin e lartë të pavarësisë me të cilën operon.

Ky dokument e plotëson Strategjinë e Politikës Makroprudenciale ("Strategjinë"), duke mundësuar një vështrim më të hollësishëm mbi mënyrën e zbatimit të politikës makroprudenciale nga Banka e Shqipërisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe karakteristikat e sistemit financiar vendas.

2.2 Roli i politikës makroprudenciale dhe natyra e rrezikut sistematik

Sistemi financiar kryen disa funksione të rëndësishme për ekonominë, të tilla si: kanalizimi i kursimeve drejt investimeve, lehtësimi i pagesave dhe administrimi i rreziqeve. Çdo dështim i sistemit financiar ndaj kryerjes së këtyre funksioneve sjell kosto të larta për operatorët ekonomikë, me implikime të mundshme sistemike për stabilitetin financiar të vendit.

Politika Makroprudenciale (PMP) shërben për të kryer analizën dhe vlerësimin e rrezikut sistematik dhe përfshin zbatimin e masave, kryesisht të natyrës prudenciale, me qëllim zvogëlimin e këtij rreziku.

Rreziku sistematik përfaqëson mundësinë që stresi në sistemin financiar të sjellë pasoja negative të rënda për funksionimin e sistemit financiar dhe ekonomisë reale. Rreziku sistematik mund të shfaqet në dimensionet ciklik dhe strukturor.

Dimensioni *ciklik* i rrezikut sistematik buron nga prirja e institucioneve financiare për të marrë përsipër më shumë rrezik në periudha të rritjes ekonomike, dhe për t'u shfaqur tepër të tërhequr gjatë periudhave të rënies ekonomike. Ndaj, në fazën rritëse të ciklit ekonomik, bankat kanë prirje të ekzpozohen ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë dhe likuiditetit, të mbështetura shpesh në zgjerimin e mospërputhjes mes aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat e tyre financiare. Në fazën rënëse të ciklit ekonomik, bankat kanë prirje të tkurrin bilancet (aktivitetin) duke shitur ekzpozimet e ngjashme ose duke kufizuar huadhëninën në mënyrë të ndjeshme. Zhvillimet e paqëndrueshme financiare gjatë fazës rritëse të ciklit ekonomik mund të çojnë në shitje të nxituar të aktiveve dhe rënie të fortë të çmimit të tyre, dobësim të bilanceve, stres të situatës së financimit dhe tkurrje të kreditimit, gjatë fazës rënëse të ciklit. Ndikimi negativ ekonomik mund të përhapet më tej përmes lidhjeve makrofinanciare, ku kushtet financiare më të shtrënguara i detyrojnë huamarrësit të zvogëlojnë nivelet e borxhit (*deleverage*) duke sjellë rënie të mëtejshme të konsumit dhe investimeve.

Dimensioni *strukturor* i rrezikut sistematik buron nga shpërndarja e rreziqeve nëpër pjesët e ndryshme të sistemit financiar. Ai shfaqet në rastet kur institucionet financiare janë aq të mëdha dhe/ose aq të ndërlidhura sa që kur ato preken nga një zhvillim i pafavorshëm ekonomik ose

financiar, lokal ose ndërkufitar, pasojat mund të kërcënojnë stabilitetin e të gjithë sistemit financiar. Ndërlidhja përfshin ekspozimin e bankave ndaj njëra-tjetrës, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (për shembull, përmes ekspozimeve të zakonshme ndaj aktiveve të ngjashme). Bankat me rëndësi sistemike ose institucionet e tjera financiare, si edhe infrastruktura mbështetëse financiare janë faktorë domethënës në këtë dimension të rrezikut sistematik.

Pikësnyimi përfundimtar i PMP-së është të mbrojë stabilitetin e sistemit financiar si një i plotë (bankat, fondet e investimeve, sigurimeve, tregjet etj.), duke parandaluar dhe zvogëluar rreziqet sistemike dhe duke fuqizuar rezistencën e tij, duke siguruar kështu një kontribut të qëndrueshëm të sistemit financiar në rritjen ekonomike.

Meqë rreziku sistematik mund të ndikojë në objektivin përfundimtar të stabilitetit financiar në mënyra dhe forma të ndryshme, PMP-ja identifikon objektivat e ndërmjetëm të përkufizuara nga rekomandimi² i BERRS, që janë:

- a) *të zbusë dhe të parandalojë rritjen e tepruar të kreditimit dhe huamarrjes.* Rritja e tepruar e kreditimit është identifikuar si çelësi i zhvillimit të krizave financiare, me anë të së cilës financimi përmes huamarrjes së paqëndrueshme shërben si një kanal përcjellës;
- b) *të zbusë dhe të parandalojë mospërputhjen e tepruar në maturim dhe mungesën e likuiditetit të tregut.* Mbështetja në financime afatshkurtra dhe të paqëndrueshme mund të çojë në nevojën për shitjen e menjëhershme të aktiveve, një treg me mungesë likuiditeti dhe pasoja në institucionet financiare;
- c) *të kufizojë përqëndrimet e ekspozimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthorta.* Përqëndrimet e ekspozimit rrisin ndjeshmërinë e sistemit financiar ndaj goditjeve, si përmes ndikimit në bilance ashtu edhe përmes shitjeve të menjëhershme të aktiveve dhe përhapjes së ndikimit mes institucioneve financiare;
- d) *të kufizojë marrjen e rrezikut të tepruar nga institucionet financiare me rëndësi sistemike.* Kjo kërkon forcimin e rezistencës së këtyre institucioneve;
- e) *të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit të infrastrukturës financiare.* Kjo lidhet me proceset dhe instrumentet që mund të zbatohen për të ulur rreziqet e kreditimit, likuiditetit dhe ato operationale në sistemin e pagesave dhe të shlyerjeve ose në infrastrukturat kritike të ngjashme.

Në lidhje me fushën e zbatimit, PMP-ja duhet të shtrihet në të gjithë sistemin financiar dhe të ekzaminojë ndërveprimin e tij me ekonominë reale. Në praktikë, sidomos për sistemet financiare që mbizotërohen nga bankat, PMP-ja fokusohet në sistemin bankar, institucionet financiare jobankare kryesore dhe infrastrukturën financiare ndihmëse, ecuria e qëndrueshme e së cilave ka rëndësi kritike për stabilitetin financiar.

2.3 Roli kryesor i bankës qendrore në zbatimin e politikës makroprudenciale

Tradicionalisht, bankat qendrore janë përgjegjëse për zbatimin e politikës monetare, kanë qasje ndaj burimeve të konsiderueshme që përdoren në analiza makroekonomike dhe financiare, mund

² Në anglisht: *ESRB/2013/1*.

të ndikojnë në likuiditetin e sistemit financiar në mënyrë të menjëhershme, veprojnë si huadhënësit e shkallës së fundit, promovojnë zhvillimet e sistemit të pagesave dhe mbikëqyrin infrastrukturën kritike të tyre, dhe monitorojnë tregjet financiare duke përfshirë tregjet ndërbankare dhe të shkëmbimit valutor. Për këto arsye, bankat qendrore janë një zgjedhje e natyrshme në rolin e autoritetit makroprudencial ose për të qenë kontribuesi kryesor brenda autoritetit makroprudencial kur ky i fundit ngrihet si një komitet ndërinstitucional.

Në rastet kur banka qendrore është përgjegjës edhe për mbikëqyrjen mikroprudenciale, identifikimi i saj si autoriteti makroprudencial bëhet me i qartë. Ky rol mund të ushtrohet nga një Komitet ose Bordi i tij i kryesuar nga Guvernatori, ku marrin pjesë edhe Zëvendësguvernatorët përgjegjës për stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen mikroprudenciale. Në kryerjen e këtyre detyrave, banka qendrore bashkërendohet me autoritetet e tjera kombëtare që kanë rol për ruajtjen e stabilitetit financiar.

Kur banka qendrore nuk është mbikëqyrësi mikroprudencial, autoriteti makroprudencial mundet me shumë gjasë të marrë formën e një komiteti ndërinstitucional, përsëri me një rol udhëheqës në bankën qendrore duke pasur parasysh përgjegjësitë e saj për politikën monetare, për monitorimin makroekonomik dhe zhvillimet financiare, kapacitetet analitike dhe përgjegjësitë e saj më të gjera mbi stabilitetin financiar³.

2.4 Ndërveprimi mes politikës makroprudenciale dhe politikave të tjera ekonomike

2.4.1 Ndërveprimi me politikën monetare

Kriza Financiare Globave e vitit 2008 tregoi se stabiliteti i çmimeve nuk garanton domosdoshmërisht stabilitet makroekonomik dhe financiar. Në këtë aspekt, nevojiten politika më specifike, si PMP-ja, që synojnë uljen e shpeshtësisë dhe të ndikimit të krizave ekonomike duke kontribuar në mbrojtjen e stabilitetit makroekonomik. Politika monetare dhe PMP-ja kanë objektiva dhe instrumente të ndryshëm, por mund të ndërveprojnë edhe sepse kanë mekaniza transmetimi të përbashkët.

Politika monetare përmes kanaleve të ndryshme, mund të ndikojë mbi stabilitetin financiar, ku ndryshimet në kushtet monetare:

- a) ndryshojnë standardet e huadhënies dhe ndikojnë probabilitetin e dështimit të huamarrësve;
- b) ndikojnë në marrjen përsipër të rrezikut të ndërmjetësve financiarë; për shembull, normat e ulëta të interesit janë një shtysë për zgjerimin e shpejtë të bilanceve dhe dëmtojnë sjelljen e kujdesshme, duke shtuar si pasojë dëshirën për rrezik në funksion të ruajtjes së nivelit të të ardhurave;
- c) mund të kenë ndikim negativ në tregjet e tjera përmes çmimeve të aktiveve; për shembull: normat e ulëta të interesit mund të shkaktojnë rritjen e çmimeve të aktiveve financiare që, nga ana e tyre mund të shkaktojnë rritjen e nivelit të borxhit, e ky mund të rrisë çmimet e

³ Për rolin udhëheqës të bankës qendrore brenda autoritetit kombëtar makroprudencial, shiko Rekomandimin ESRB/2011/3 (ang.).

aktiveve jofinanciare, duke përforsuar kështu prirjen rritëse të ciklit financiar. Në ekonomitë e hapura, rritja e normave të interesit mund të shoqërohet nga një nivel më i lartë i flukseve hyrëse të valutave të huaja dhe nga një ndikim i padëshiruar në nivelin e kursit të këmbimit.

Nga ana tjetër, PMP-ja mund të kompensojë për efektet e mundshme të padëshiruara të politikës monetare. Për shembull, zbatimi i një kufiri ndaj nivelit të treguesit 'borxh / të ardhura' mund ta zvogëlojë probabilitetin e dështimit të shlyerjes së huamarrësve në vijim të shtrengimit të politikës monetare (rritjes së normës së interesit). Kërkesat mbi kapitalin ose kufijtë mbi nivelin e borxhit mund të ndihmojnë për të kontrolluar nivelin e huamarrjes (dhe rrezikun) tek bankat që operojnë në një mjedis me norma të ulëta të interesit. Caktimi i kufijve për normën e 'vlera e huasë / vlere e pronës' (*LTV*) mund ta ngadalësojë rritjen e çmimeve të aktiveve jofinanciare kur politika monetare lehtësuese shoqërohet me çmime më të larta të aktiveve. Zbatimi i kufijve mbi huanë në valutë mund ta pakësojë rrezikun sistemik të lidhur me flukset e kapitalit që janë të ndjeshme ndaj nivelit të normave të interesit. Politikat makroprudenciale mund të kenë ndikim mbi përbërjen dhe nivelin e prodhimit dhe inflacionit, duke qenë se ato ndikojnë flukset e kreditimit.

Përvoja e përdorimit të politikave makroprudenciale së bashku me ato monetare, për të arritur stabilitetin financiar dhe të çmimeve, është aktualisht e kufizuar. Teksa përdorimi dhe vlerësimi i instrumenteve makroprudencialë ka një përvojë të shkurtër, ekziston rreziku që ato të ndërveprojnë në mënyrë të papërshtatshëm me politikën monetare. Nga ana tjetër, aty ku përdorimi i politikës monetare është i kufizuar, mund të ketë arsye më të fortë për të përdorur PMP-në. Si në rastin e politikave të tjera ekonomike, një varësi e plotë mbi PMP-të, ndonëse e mundur në një periudhë kohe afatshkurtër, nuk është e këshillueshme meqë rreziqet e stabilitetit financiar zakonisht kërkojnë politika të tjera strukturore apo fiskale, për t'u trajtuar në mënyrë të përshtatshme.

2.4.2 Ndërveprimi me politikën mikroprudenciale

Ndryshimet mes politikave makro dhe mikroprudenciale duhet të kuptohen drejtë. Objektivi kryesor i mbikëqyrjes mikroprudenciale është siguria dhe stabiliteti i bankave të veçanta (ose i çdo institucioni financiar jobankë), si edhe ulja e probabilitetit dhe ndikimit të dështimit të një banke. Kriza globale financiare tregoi që shëndeti i institucioneve financiare individuale është i domosdoshëm por i pamjaftueshëm për shëndetin e përgjithshëm të sistemit financiar. Ndaj, ekziston nevoja e PMP-së, e cila synon ruajtjen e stabilitetit të të gjithë sistemit financiar duke parandaluar grumbullimin e rrezikut sistemik dhe duke përmirësuar rezistencën e tij.

Për shkak të fokusit specifik, mbikëqyrja mikroprudenciale mund të ofrojë këndvështrime të dobishme që orientojnë analizën dhe vendimet makroprudenciale, duke ndihmuar edhe në ushtrimin efektiv të masave makroprudenciale nëpër institucionet financiare. Njëkohësisht, analiza makroprudenciale mund të identifikojë rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohen institucionet financiare individuale. Në vijim, mbikëqyrësit mund të angazhohen me këto institucione për mënyrën e adresimit të rreziqeve të identifikuara.

Pavarësisht se politikat makro dhe mikroprudenciale janë të ndërlidhura ngushtësisht, në kohën afatshkurtër ato mund të realizojnë objektivat dhe të përdorin instrumente që, në situata të caktuara, mund të jenë në konflikt. Për shembull, gjatë një periudhe ekonomike në rënie,

mbikëqyrja mikroprudenciale mund të kërkojë rritjen e nivelit të kapitalit, veçanërisht të bankave, për të përthithur më mirë humbjet në kreditim, duke prodhuar efekte negative prociklike të huadhëniet e të gjithë sistemit. Në të njëjtën mënyrë, gjatë një periudhe të rritjes ekonomike, nevoja për të adresuar ekspozimet më të larta ndaj rrezikut nga një perspektivë makroprudenciale mund të duket sikur është në konflikt me situatën e shëndetshme financiare të bankave individuale. Rrjedhimisht, është me dobi të zhvillohet një process që lejon bashkëpunimin mes politikave mikro dhe makroprudenciale dhe, nëse është e nevojshme, përcaktimin e përparësive në përputhje me situatën.

2.4.3 Ndërveprimi me kuadrin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Zbatimi në kohën e duhur i masave makroprudenciale që rrisin rezistencën e bankave (ose institucioneve të tjera financiare) është i rëndësishëm për kornizën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Institucionet financiare me rëndësi sistemike (aktualisht, bankat) ose ato ku ndërhyrja e jashtëzakonshme është e këshillueshme për shkak të shqetësimeve të "interetit publik", janë pjesë e fushës së zbatimit të të dyja kornizave. Nëse institucionet me rëndësi sistemike indentifikohen me kujdes dhe rezistenca e tyre rritet përmes masave makroprudenciale, atëherë korniza e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për këto institucione (planfikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ndërhyrja etj.) bëhet më pak e mundshme, më e parashikueshme dhe më pak e kushtueshme. Nga ana tjetër, arritja e nivelit të kërkuar të shtesave të kapitalit mund të jetë më e vështirë në ato situata kur detyrimet e pranuar janë të pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat minimale të kapitalit dhe detyrimeve të pranuar (*MREL*) për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Përsëri, shkëmbimi i informacionit në kohën e duhur mes dy fushave mbetet kritik për përgjigjen efektive të secilës prej politikave.

2.4.4 Ndërveprimi me politikën fiskale

PMP-ja mund të ndërveprojë edhe me politikat e tjera shtetërore, siç është politika fiskale. Për shembull, interpretimet fiskale që i konsiderojnë pagesat e interesit të kreditve për pasuritë a patundshme "të zbritshme për arsye tatimore", mund të kompensojnë ose të ç'orientojnë ndikimin e masave makroprudenciale që synojnë të adresojnë rreziqet që lindin nga zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme. Për më tepër, efektiviteti i masave makroprudenciale që synojnë të zvogëlojnë rreziqet sistemike strukturore të lidhura me përdorimin e gjerë të valutës, mund të dëmtohet nëse ato nuk shoqërohen nga masa të ngjashme në fushën fiskale të lidhura me ekonominë reale. Masat makroprudenciale mund të ndikojnë prirjet në segmenteve të veçanta të tregut që kanë rëndësi për politikën publike. Për shembull, masat makroprudenciale që ndikojnë tregun e titujve të borxhit të qeverisë ose tregun e pronave të paluajtshme (si masat e bazuara te huamarrësit) mund të jenë veçanërisht të ndjeshme dhe të kërkojnë një analizë të plotë të kostove dhe përfitimeve, pasuar nga një shpjegim dhe arsyetim i qartë.

2.4.5 Ndërveprimi me politikën e konkurrencës

PMP-ja mund të ketë ndikim edhe në politikën e konkurrencës. Për shembull, shtesat e kapitalit për institucionet me rëndësi sistemike, që shërbejnë për të reflektuar kontributin e tyre më të lartë në rrezikun sistematik, mund të ndihmonjë në ngadalësimin e rritjes së tyre në të ardhmen dhe të

lejojnë kështu hapësirë më të madhe për konkurrencën e drejtë në treg nga institucionet me madhësi më të vogël. Kjo sjell përfitime për stabilitetin financiar dhe konsumatorët e shërbimeve financiare. Ky shembull nxjerr gjithashtu në pah rëndësinë e përgjithshme të zbatimit të instrumenteve makroprudencialë me parimin e proporcionalitetit, që i kushton vëmendjen e duhur kontributit që kanë disa institucione, ekspozime ose produkte në rrezikun sistematik. Nga ana tjetër, një treg konkurrues dhe i larmishëm, që rrjedhimisht nuk varet nga një numër i vogël institucionesh që financojnë ekonominë, është sigurisht i dobishëm për stabilitetin financiar pasi ul luhatshmërinë e episodeve të sresit dhe, për çështjet e zhvillimit të rrezikut, lejon zgjidhje që mbështeten më tepër tek tregu. Në këto situata, në rradhë të parë ndërhyrja makroprudenciale është krahasimisht më pak e nevojshme dhe ndoshta më tepër e efektshme kur vihet në zbatim, pasi ekziston një hapësirë më e vogël për shmangje nga subjektet.

III. Korniza institucionale e politikës makroprudenciale në Shqipëri

3.1 Roli i Bankës së Shqipërisë në zbatimin e politikës makroprudenciale në Shqipëri

Korniza ligjore⁴ e përkufizon Bankën e Shqipërisë si bankën qendore të vendit, e cila zbaton politikën monetare për të arritur objektivin e saj kryesor, atë të stabilitetit të çmimeve dhe njëkohësisht, në realizimin e objektivave të tjera, vepron si autoriteti mbikëqyrës, rregullator dhe i ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat që operojnë në Shqipëri, promovon funksionet e sistemeve të pagesave dhe përcakton rregullat për parandalimin dhe administrimin e rrezikut sistematik.⁵ Gjithashtu, Banka e Shqipërisë merr pjesë në GKSF⁶ i cili fokusohet në parandalimin dhe administrimin e rrezikut sistematik në sistemin financiar, ku sektori bankar ka peshë mbizotëruese.

Tabela 1: Sistemi financiar në Shqipëri (% e PBB)

| Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës | | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 6M I - 2020 |
|-------------------------------------|-----------------------------------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------------|
| Banka e Shqipërisë | Spektori bankar | 88.1 | 92.1 | 94.8 | 97.6 | 97.3 | 100.5 | 99.4 | 96.0 | 95.5 | 99.4 |
| | Institucionet financiare jo-banka | 2.7 | 2.7 | 2.7 | 3.0 | 2.9 | 3.0 | 3.1 | 3.5 | 4.2 | 4.4 |
| | SHKK dhe Unionete tyre | 0.8 | 0.8 | 0.7 | 0.8 | 0.8 | 0.6 | 0.6 | 0.6 | 0.7 | 0.7 |
| Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare | Shoqëri sigurimi | 1.5 | 1.6 | 1.7 | 1.9 | 2.1 | 2.1 | 2.1 | 2.1 | 2.2 | 2.6 |
| | Fondet e pensionit | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.2 | 0.2 | 0.2 |
| | Fonde investimi | | 1.2 | 3.9 | 4.8 | 5.0 | 4.7 | 5.0 | 4.5 | 4.3 | 4.4 |
| Ndërmjetësi financiar | | 93.1 | 98.6 | 103.8 | 108.2 | 108.0 | 111.0 | 110.3 | 106.9 | 107.2 | 111.6 |

⁴ Roli kryesor i Bankës së Shqipërisë përcaktohet nga Ligji nr. 8269, data 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë," i ndryshuar (më tej, Ligji Organik), Ligji nr. 9662, data 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë," i ndryshuar (më tej, Ligji për bankat); dhe Ligji nr. 133/2016, data 22.12.2016 "Për rimbëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme të bankave në Republikën e Shqipërisë".

⁵ Ligji për bankat, Neni 66/1.

⁶ Ligji nr. 9572, data 03.07.2006 "Për autoritetin e mbikëqyrjes financiare", i ndryshuar, Neni 30. Anëtarët e GKSF kanë firmosur një memorandum në 10.03.2014.

Mbështetur në funksionet e saj dhe duke marrë parasysh peshën dominuese të sektorit bankar në aktivitetin e përgjithshëm të sistemit financiar, Banka e Shqipërisë e gjen veten në pozicionin e natyrshëm të autoritetit shtetëror që kryeson zbatimin e PMP-së. Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera në ligje parashikojnë të drejtën e Bankës së Shqipërisë për të ushtruar funksionet e saj në mënyrë të pavarur, me qëllim që të përmbushë objektivat në mënyrë të efektshme. Për zbatimin e PMP-së, Banka e Shqipërisë zbaton të njëjtin parim të pavarësisë, duke njohur njëkohësisht rëndësinë e transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit me autoritetet e tjera, për të zbutur rrezikun sistemik dhe për të mbrojtur stabilitetin financiar.

3.2 Autoritetet e tjera shqiptare që kontribuojnë në stabilitetin financiar

Në kornizën ligjore shqiptare, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka përgjegjësi për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare jobanka, duke përfshirë shoqëritë e sigurimeve, fondet e investimit, fondet e pensionit, bursat dhe brokeruesit. Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) ka përgjegjësi të administrojë dhe të përdorë fondin e sigurimit të depozitave kur Banka e Shqipërisë vendos që duhet të paguajë depozituesit e siguruar të një banke të dështuar. Për ta bërë këtë, Agjencia administron një bazë të dhënash të përditësuar dhe të detajuar për depozitat e sigurara të secilës bankë, dhe duhet të jetë e gatshme të paguajë fondin e sigurimeve për depozitat e ligjshme kur lind nevoja. Ministria e Financës ka një interes të vërtetë dhe luan një rol kritik në zhvillimin e tregjeve financiare në Shqipëri. Ajo mund të ketë ndikim në aktivitetin e këtyre tregjeve në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes operacioneve financiare të buxhetit dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, me anë të akteve ligjore që miraton për veprimet që kryen me të ardhurat publike dhe shpenzimet ose, më gjerësisht, për aktivitetin ekonomik të bizneseve dhe individëve.

Bashkëpunimi mes Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, AMF-së dhe ASD-së bëhet i mundur kryesisht përmes pjesëmarrjes së këtyre institucioneve në GKSF. Ky forum është një platformë e përshtatshme për të shkëmbyer informacion, për të diskutuar vlerësimet rreth stabilitetit financiar dhe rreziqet përkatëse, për të kryer vlerësimet e ndikimit dhe për të bashkërenduar sjelljet që lidhen me veprimet dhe çështjet e tjera që i përkasin PMP-së.

Për më tepër, Banka e Shqipërisë inkurajon bashkëpunimin dypalësh përmes zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me agjencitë e tjera rregullatore, në mënyrë që t'i shtyjë ato të kontribuojnë në marrjen e masave për zbutjen e rrezikut në segmentet e sistemit financiar që mbikëqyren prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Banka e Shqipërisë gjithashtu komunikon me industrinë bankare rreth pozicioneve të saj të PMP-së me qëllim vlerësimin e rrezikut, kalibrimin e instrumenteve dhe zbatimin efektiv të tyre.

3.3 Bashkëpunimi ndërkufitar

Prania e bankave dhe e institucioneve jobanka të huaja, si edhe pesha e tyre domethënëse në sistemin financiar shqiptar, evidenton nevojën për bashkëpunim ndërkufitar. Në sektorin bankar shqiptar, bankat me origjinë nga Bashkimi Evropian zënë më shumë se gjysmën e peshës së aktiveve totale dhe kontribuojnë me një vlerë të ngjashme në ndërmjetësimin financiar. Në përputhje me nevojat dhe me hapësirën që ekziston në përkufizimet ligjore të juridiksioneve

përkatëse, Banka e Shqipërisë kërkon bashkëpunim me autoritetet makroprudenciale evropiane. Kjo hapësirë pritet të zgjerohet dhe të rrisë detyrimet e palëve, përgjatë procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kornizën e zbatimit të PMP-së, parimet e interesit dypalësh dhe kërkesat ligjore do e lehtësojnë bashkëpunimin edhe me autoritete të tjera të huaja.

3.4 Procesi i brendshëm i vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë

Zbatimi i PMP-së varet nga vendimmarrja efektive dhe procesi i komunikimit për përdorimin e instrumenteve makroprudencialë. Ky proces informohet nga informacioni përkatës sasior dhe cilësor që disponohet. Strukturat përkatëse të Bankës së Shqipërisë analizojnë zhvillimet e rrezikut mbështetur në prirjet dhe nivelet e treguesve përkatës, si edhe në përvojën e përdorimit të instrumenteve. Në këtë fazë, vlerësohen edhe çështjet ligjore dhe ndërveprimi i veprimeve makroprudenciale me politikat e tjera.

Strukturat e Bankës së Shqipërisë që janë të përfshira në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme, me zbatimin e PMP-së, përfshijnë:

- *Departamenti i Stabilitetit Financiar*, që monitoron treguesit e rrezikut sistematik, zhvillon metodologjinë e vlerësimit të tij dhe të operacionalizimit të instrumenteve makroprudencialë, propozon në Komitetin Këshillimor të Stabilitetit Financiar instrumentin dhe mënyrën e zbatimit, monitoron ndikimin e instrumentit, përgatit raportet dhe analizat për ecurinë e rrezikut sistematik si edhe bën vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar;
- *Komiteti Këshillimor i Stabilitetit Financiar*, që vlerëson ecurinë e rreziqeve sistemike, përzgjedh instrumentin makroprudencial dhe përcakton mënyrën e zbatimit të tij, monitoron koordinimin e punës për diskutimin brenda institucionit dhe përgatitjen e akteve ligjore ose nënligjore që nevojiten për zbatimin e instrumentit, formulon qëndrimet makroprudenciale për Guvernatorin ose Këshillin Mbikëqyrës;
- *Guvernatori*, që komunikon qëndrimet e Bankës së Shqipërisë për rreziqet sistemike dhe qëndrueshmërinë e stabilitetit financiar, dhe vendos për zbatimin e instrumentit makroprudencial;
- *Këshilli Mbikëqyrës*, që merr në shqyrtim dhe miraton raportet dhe analizat e Bankës së Shqipërisë për vlerësimin e gjendjes së stabilitetit financiar, informohet mbi vlerësimet për mënyrën e zbatimit të politikës makroprudenciale, si dhe miraton aktet e ndryshme nënligjore të nevojshme për zbatimin e instrumenteve përkatëse të politikës makroprudenciale.

Vlerësimi i ndikimit të instrumenteve makroprudencialë të zbatuar duhet të kryhet rregullisht për të kuptuar më mirë mekanizmin e transmetimit dhe mënyrën e ndikimit. Ky proces përfshin vlerësimin e shkallës së plotësimit të objektivave, ndikimin e instrumentit dhe nëse ka pasur efekte të paqëllimshme të tij ose aktivitete që synojnë ta shmangin atë.

IV. Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut sistemik

Vendimet e politikës makroprudenciale merren pas analizës së zhvillimeve të rrezikut sistemik. Vlerësimi i rrezikut sistemik mbështetet në informacionin cilësor dhe sasior që mblidhet dhe organizohet nga Banka e Shqipërisë. Për organizimin dhe analizimin e këtij informacioni ndërmerren disa procese.

4.1 Vlerësimi sasior: cilësia e të dhënave

Për të mbështetur analizën makroprudenciale, të dhënash sasiore gjithëpërfshirëse grumbullohen nga bankat, përmes raporteve financiare të rregullta. Gjithashtu, të dhënat grumbullohen brenda Bankës së Shqipërisë përmes informacionit të shkëmbyer mes funksioneve relevante dhe aksesit në statistika që prodhohen brendapërbrenda.

Zhvillimet në sektorin financiar jobankar mund të jenë gjithashtu të rëndësishme për stabilitetin financiar. Për shembull, industria e fondit të investimeve në periudha trysnie mund të vuajë nga episode të stresit të likuiditetit dhe luhatshmërisë në tregjet e titujve. Ky stres mund të përhapet në sistemin financiar, simdomos kur industria e fondeve të investimeve është e madhe, me një nivel domethënës ndërlidhshmërie, dhe korniza e mundësimit të likuiditetit për këtë industri, gjatë periudhave të stresit, mungon ose është e papërshtatshme. Në Shqipëri, ky segment i sistemit financiar është nën kontrollin e AMF-së. Banka e Shqipërisë po bashkëpunon me AMF-në për të përmirësuar gadishmërinë dhe cilësinë e të dhënave të fondit të investimeve, ku të dhëna të strukturuar për tërheqjet, përbërjen e investimeve, përputhshmërinë me kërkesat e likuiditetit, përfaqësojnë nivelin minimal të informacionit që kërkohet.

Politika makroprudenciale gjithashtu monitoron zhvillimet në ekonominë reale. Për të arritur këtë qëllim, të dhëna më cilësore grumbullohen nga komunikimi direkt me subjektet e mbikëqyryra, ndjekja nga afër e raporteve që lëshon Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe vrojtimet e rregullta me agjentët ekonomikë. Për shembull, për të përfutur informacion më të mirë rreth individëve dhe bizneseve, me mbështetjen teknike të INSTAT, Banka e Shqipërisë përdor vrojtimet gjashtëmujore për Situatën Financiare të Individëve dhe Korporatave Jofinanciare. Gjithashtu, përvoja mbarëbotërore ka treguar rëndësinë që kanë zhvillimet e tregut të pronave të paluajtshme në stabilitetin financiar, për shkak të rolit të veçantë që pronat e paluajtshme luajnë si aktive që mund të gjenerojnë (kur përdoren si kolateral) dhe të tërheqin (kur përdoren si shënjestër investimi) financim nga bankat dhe pjesa tjetër e sistemit financiar, duke përfshirë si individët ashtu edhe bizneset. Kjo marrëdhënie mund të çojë në përhapjen e rreziqeve të stabilitetit financiar që burojnë nga zhvillimet e paqëndrueshme që mund të kërkojnë korrigjim dhe të shkaktojnë humbje për palët e përfshira. Banka e Shqipërisë mund të monitorojë në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimet e kredive të pasurive të paluajtshme dhe, në mënyrë proaktive, ka zhvilluar një vrotim⁷ gjashtëmujor që fokusohet në tregun e pronave të paluajtshme rezidenciale (PPR), që lejon të ndërtohet indeksi i çmimeve të PPR. Megjithëse është e nevojshme për të arritur një vlerësim të shëndetshëm të zhvillimeve përkatëse të këtij tregu, më tepër është e nevojshme për të llogaritur ndërlikimet që

⁷ Vrojtimi është publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë:
https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Analiza_dhe_studime/Vrojtime/

karakterizojnë marrdhënien mes financimit dhe pronave të paluajtshme. Në këtë aspekt, nevojitet bashkëpunimi me autoritetet e tjera, për të zgjeruar dhe përmirësuar cilësinë e të dhënave (për shembull, përmes sigurimit të aksesit në të dhënat e tregut të pronave të paluajtshme mundësuar nga agjencitë administrative shtetërore) dhe për të zhvilluar një indeks kombëtar dhe gjithëpërfshirës për çmimet e tregut të pronave të paluajtshme rezidenciale dhe tregtare. Një bashkëpunim i tillë mund të kërkojë një mbështetje ligjore më të qartë dhe mund të bëhet më i lehtë me anë të marrëveshjeve specifike ndërinstitucionale ose memorandumëve të bashkëpunimit.

Sigurimi i të dhënave të cilësisë më të lartë, mundëson identifikimin e shpejtë të mënyrës së përhapjes së rrezikut sistematik në sistemin financiar dhe përmirëson fushën e zbatimit të PMP.

4.2 Vlerësimi cilësor

Përpyekja për sigurimin e të dhënave sa më të mira është e vazhdueshme. Por zotërimi i të dhënave dhe informacionit të mirë, edhe pse i nevojshëm, mund të mos jetë i mjaftueshëm për të zbatuar politika ekonomike të efektshme. Të dhënat duhet të interpretohen në mënyrën e saktë. Për të arritur këtë, ekspertët duhet të kërkojnë dhe të zbatojnë një vështrim më të gjerë që përfshin verifikimin dhe testimin e cilësisë së të dhënave, krahasimin e informacionit aktual me prirjet historike, krahasimi/arsyetimin e tij me zhvillime të ngjashme në juridiksione të tjera ose tregje vendore, vlerësimin nëse të dhënat shfaqin një model ciklik ose ndryshim strukturor, gjetjen e arsyeve të qëndrueshme që përgjithësisht i shpjegojnë ato, dhe vlerësimin nëse kërkohet një përgjigje dhe si mund të konceptohet ajo.

Në Bankën e Shqipërisë ekziston një proces për të garantuar cilësinë e të dhënave dhe për të përftuar komente dhe opinione nga funksione të ndryshme, të cilat ndihmojnë në hartimin e analizës makroprudenciale dhe të raporteve përkatëse. E njëjta gjë vlen edhe për vlerësimin e ndikimit dhe nevojës së rishikimit të masat makroprudenciale. Ky proces lejon diskutime si në nivelin teknik ashtu edhe në atë administrativ. Kuptohet që përmes këtij procesi analiza makroprudenciale pasurohet dhe procesi i vendimmarrjes përmirësohet.

4.3 Roli i provave të rezistencës në kornizën makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë

Bankat qendrore dhe mbikëqyrësit e bankave mbështeten në provat e rezistencës si një mjet mbikëqyrës dhe makroprudencial, për të ndihmuar në përcaktimin dhe vlerësimin e dobësive dhe rreziqeve në institucionet financiare, në rast të një ndryshimi serioz në strukturën makroekonomike ose situata të tjera shume të rralla por të mundshme (rreziqet ekstreme). Ushtrimet e provës së rezistencës paraqesin një kornizë si për (i) të vlerësuar rezistencën e bankave individuale dhe sektorit bankar, ashtu edhe për (ii) të përcaktuar nevojat e tyre të kapitalit. Për më tepër, provat e rezistencës shërbejnë si një mjet mbikëqyrës parandalues, për të inkurajuar bankat të identifikojnë dobësitë dhe të zhvillojnë planet e zbutjes së rrezikut.

Kryesisht, provat e rezistencës mund të përvijohen në dy mënyra. E para, qasja “nga lart poshtë”, ku mbikëqyrësi i bankës paraqet skenarin (skenarët) negativ dhe banka vlerëson ndikimin e këtij skenari në bilancin e saj dhe në kapital. Qasja e dytë është “nga poshtë lart”, ku autoriteti

mbikëqyrës drejton të gjithë procesin, mbështetur në skenarët e përzgjedhur, modelet e zbatueshme dhe të dhënat e mbledhura rregullisht nga bankat.

Banka e Shqipërisë kryen prova të rezistencës 'nga lart-poshtë' dhe 'nga poshtë-lart' për rrezikun e aftësisë paguese dhe prova të rezistencës së likuiditetit për rrezikun e likuiditetit. Aktualisht, provat e rezistencës 'nga poshtë-lart' bëhen çdo vit dhe përfshijnë disa banka që aktualisht zënë rreth 65% të aktiveve totale në sektorin bankar. Banka e Shqipërisë iu ofron bankave pjesëmarrëse shkallen e supozuar të goditjes ndaj variablave makroekonomikë të lidhura me rrezikun e kreditimit dhe rrezikun e tregut (kursi i këmbimit, normat e interesit), si edhe të dhëna metodologjike të tjera. Bankat pritet të vlerësojnë ndikimin e këtyre goditjeve në ecurinë e tyre financiare dhe mbi pozicionin e tyre të kapitalit. Një përmbledhje e rezultateve të provave të rezistencës qarkullohet brenda Bankës së Shqipërisë me departamentet përkatëse (Departamentet e Mbikëqyrjes dhe të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme).

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë kryen prova të rezistencës 'nga lart-poshtë' dhe analizën e ndjeshmërisë, duke përfshirë çdo bankë, në çdo tre muaj. Goditjet mbi treguesit makroekonomikë për këto prova mundësohen nga departamentet e Politikës Monetare, të Operacioneve Monetare dhe të Kërkimeve. Me anë të një modeli financiar, goditjet makroekonomike përkthehen në goditje në treguesit e kreditimit dhe të tregut, që më vonë ndikojnë në nivelin e ecurisë financiare dhe të kapitalit të bankave. Rezultatet e provave të rezistencës shkëmbehen me departamentet e tjera përkatëse, dhe një përmbledhje botohet në Raportin e Stabilitetit Financiar. Analiza e ndjeshmërisë, që vlerëson ndjeshmërinë e bankave ndaj goditjeve të paracaktuara në kreditë me probleme, kurset e këmbimit dhe normat e interesit, dhe një kombinim i të gjithave, zhvillohet rregullisht dhe qarkullohet në mënyrë të njëjtë brendapërbrenda institucionit.

Prova e rrezikut të likuiditetit zhvillohet çdo vit me të gjitha bankat. Në këtë ushtrim bankat i raportojnë Bankës së Shqipërisë aktivet dhe detyrimet në valutat kryesore, të ndarë sipas shportave të paracaktuara të maturimit, si edhe flukset përkatëse hyrëse dhe dalëse dhe nivelin e aktiveve likuide në valutat përkatëse. Për qëllimin e ushtrimit, Banka e Shqipërisë vlerëson shkallen në të cilën banka është e aftë të përballet me goditjet e flukseve dalëse, duke konsideruar flukset hyrëse kontraktuale të rregulluara ose përdorimin e kapaciteteve të saj kundërpeshuese (aktive me maturitet mbi 12 muaj që mund të likuidohen nëse lind nevoja). Sërish, rezultatet qarkullohen mes departamenteve përkatëse në bankë por nuk publikohen.

Banka e Shqipërisë mund të kryejë më tepër ushtrime të provës së rezistencës, sipas nevojave. Kohët e fundit, Banka e Shqipërisë po punon për zhvillimin e kornizës së provave të rezistencës për përhapjen e rrezikut përmes përcjelljes, që buron nga ndërlidhja mes bankave dhe institucioneve financiare jobanka, dhe për kombinimin e tyre në një kornizë të vetme me provën e aftësisë paguese.

4.4 Harta e rreziqeve makroprudenciale (*heatmap*) e Bankës së Shqipërisë

Për të vlerësuar zhvillimet e rrezikut sistemik në sistemin financiar dhe në ekonomi dhe për të informuar vendimet makroprudenciale, gjatë vitit 2018 Banka e Shqipërisë zhvilloi një listë me treguesit sasiorë që mbulojnë 4 objektivat e parë të ndërmjetëm.

Treguesit e përzgjedhur të lidhur me rrezikun që buron nga *rritja e tepërt e kreditimit dhe e huamarrjes* (objektivi i parë i ndërmjetëm) përfshin parametrat e rritjes së kreditimit bankar, peshën e stokut të kreditimit bankar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe devijimin e këtij raporti nga niveli i tij afatgjatë (hendeku i kredisë ndaj PBB-së). Fokusi është te kreditë që bankat i japin sektorit privat (individëve dhe bizneseve) sepse ky është kanali kryesor që krijon borxhin në vend. Më pas, përzgjidhen tregues të tjerë të lidhur me përbërjen sektorale dhe valutore të kredisë. Qëllimi është të kuptohet dhe të identifikohet se cili nga sektorët përbën kontributin kryesor potencial në rritjen e tepërt të kreditimit, që më pas të përcaktohen masat korrigjuese të mundshme. E fundit në radhë por jo në rëndësi, treguesit e përzgjedhur referojnë ecurinë e tregut të pronave të patundshme. Njihet fare mirë në literaturë se rritja e tregjeve të pronave të paluajtshme financohet shpesh me kredi bankare. Kur kjo rritje bëhet e paqëndrueshme, cilësia e kredisë bie dhe përkthehet në humbje për bankat. Për të kuptuar zhvillimet në tregun e pronave të paluajtshme, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar dhe monitoron një indeks të çmimeve për pronat rezidenciale, si edhe prirjet e kredisë bankare për pronat e paluajtshme.

Përsa i përket objektivit të dytë të ndërmjetëm lidhur me rreziqet që burojnë nga *diferencat në afatet e maturimit dhe mungesa e likuiditetit të tregut*, treguesit e përzgjedhur monitorojnë ndryshimet në nivelin e aktiveve likuide, si dhe në hendekun e afatit të maturimit mes aktiveve dhe detyrimeve. Mjaftueshmëria e aktiveve likuide vlerësohet kundrejt detyrimeve afatshkurtra të sektorit bankar dhe llogaritet sipas monedhës kombëtare dhe valutave kryesore. Duke qenë se pozicioni i likuiditetit të bankave varet edhe nga mjaftueshmëria e aktiveve përkatëse që nuk janë lënë si garanci dhe që mund të përdoren si kolateral për të siguruar fonde likuide, ky tregues përfshihet në listën e monitorimit. Hendeqet e afateve të maturimit mes aktiveve dhe detyrimeve në shporta të ndryshme kohore (afatshkurtër – afatgjatë) janë mbledhur rregullisht nga bankat për të vlerësuar si po zhvillohen hendeqet dhe për të identifikuar nivelin e aktiveve likuide që mund të mbulojnë vlerën e flukseve kontraktuale neto (nëse është e nevojshme). Veçoria e tiparit të "likuiditetit" për çdo aktiv varet nga thellësia dhe konkurrueshmëria e tregut ku këto aktive emetohen dhe tregtohen. Në këtë rast treguesit e përzgjedhur fokusohen në parametrat e kursit të këmbimit dhe të tregut të parasë, ku monedhat mund të shkëmbehen ose titujt të tregtohen. Madhësia e ndryshimit mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes në tregtimin e monedhave apo në transaksionet me tituj (të përfshira në marrëveshjet e riblerjes ose tregtimet në tregjet dytësore), janë veçanërisht të rëndësishme në këtë rast.

Treguesit e përzgjedhur për objektivin e tretë synojnë të japin sinjale për rreziqet që burojnë nga *përqëndrimet direkte dhe të tërthorta të ekspozimit të bankave*. Këto përqëndrime monitorohen kundrejt parametrave të aftësisë paguese të bankës, institucioneve të tjera jobankare, sektorëve ekonomikë, juridiksioneve të huaja, valutave të ndryshme dhe subjekteve të mëdha ekonomike. Kur krahasohen përqëndrimet e ekspozimeve kundrejt parametrave të aftësisë paguese të bankës, fokusi bie mbi madhësinë e tyre në raport me elementët e ndryshëm të kapitalit dhe të bilancit, si edhe mbi mënyrën se si ky përputhet me kërkesat rregullatore ekzistuese. Niveli i përqëndrimeve të ekspozimit kundrejt elementëve të tjerë, vlerësohet zakonisht kundrejt niveleve të mesatareve historike.

Objekti i katërt merret me rreziqet e mundshme që burojnë nga *pozicioni mbizotërues i sektorit bankar në ekonomi dhe në tregun financiar*. Sa më i rëndësishëm ky pozicion aq më i lartë kontributi që bankat kanë në rrezikun sistemik dhe aq më e fortë është nevoja për të parandaluar dhe administruar një rrezik të tillë. Treguesit e përzgjedhur për këtë objektiv përfshijnë ato që mundësojnë të dhëna mbi pozicionin e aktiveve totale të bankës në lidhje me PBB-në, me aktivitetet totale në sistemin financiar, ose të tjera që tregojnë sa i përqëndruar është aktiviteti i bankave me rëndësi sistematike dhe i sektorit bankar në tërësi.

Për çdo tregues të përzgjedhur të çdo objekti të ndërmjetëm, janë identifikuar pragje paralajmëruese, mbështetur në prirjet historike ose përdorimin e metodave të përshtatshme statistikore. Këto pragje shërbejnë si nivele sinjalizuese për rritjen/zbritjen e rrezikut sistemik dhe potencialisht si nivele nxitëse për aktivizimin/ç'aktivizimin e instrumenteve makroprudenciale.

Treguesit lejojnë konstruktin e Hartave Makroprudenciale (*heatmaps*), të cilat përfaqësojnë një mjet të koduar me ngjyra që njofton nivelin e rrezikut sistemik sipas qasjeve "në një moment kohe të caktuar" ose "përgjatë ciklit". Qasja "në një moment kohe të caktuar" ofron nivelin aktual të treguesit të përzgjedhur dhe lejon vlerësimin e ndryshimeve të tij në 6 dhe 12 muajt e fundit.

Tabelë 2: Qasja 'Në një moment të caktuar kohe' e Hartës Makroprudenciale

| | | Harta Makroprudenciale | | | | | | |
|---|---|--|--------------------------------------|-------------------|----------------|----------------|-------------------------|------------------|
| | | Nën <-1.5 DS | Nën <-1.0 DS | Nën <-0.5 DS | Mbi >0.5 DS | Mbi >1.0 DS | Mbi >1.5 DS | |
| | | Treguesi | Pragu Krahasues | Niveli i Rrezikut | Vlera e fundit | Data e fundit | Ndryshimi gjashtëmuajor | Ndryshimi vjetor |
| Objekti 1: Zbutja dhe parandalimi i rritjes së tepëruar të kreditimit dhe raportit i levës financiare. | Treguesit e hendekut dhe levës financiare | Hendeku i kredisë bankare ndaj PBB-së | Literatura, në nivelin 2 pp | | -12.7 pp | Dec-18 | -0.4 pp | -1.6 pp |
| | | Hendeku i kredisë bankare ndaj PBB-së - Biznese | Literatura, në nivelin 2 pp | | -10.3 pp | Dec-18 | -0.4 pp | -1.5 pp |
| | | Hendeku i kredisë bankare ndaj PBB-së - Individë | Literatura, në nivelin 2 pp | | -2.4 pp | Dec-18 | -0.1 pp | -0.1 pp |
| | | Kredi Bankare ndaj PBB-së | Pa prag krahasues | | 36.3% | Dec-18 | -1.1 pp | -2.8 pp |
| | | Kredi Bankare për Biznese ndaj PBB-së | Pa prag krahasues | | 24.1% | Dec-18 | -1.0 pp | -2.7 pp |
| | | Kredi Bankare për Individë ndaj PBB-së | Pa prag krahasues | | 12.1% | Dec-18 | -0.1 pp | -0.1 pp |
| | | Rritja e portofolit të kredisë për sektorin privat | Gjykimi i ekspertëve, në nivelin 10% | | -2.8% | Dec-18 | -0.6 pp | -2.2 pp |
| | | Rritja e portofolit të kredisë për bizneset | Gjykimi i ekspertëve, në nivelin 10% | | -5.7% | Dec-18 | -0.6 pp | -2.6 pp |
| | | Rritja e portofolit të kredisë për individë | Gjykimi i ekspertëve, në nivelin 10% | | 3.8% | Dec-18 | -0.9 pp | -1.8 pp |
| | | Raporti i levës financiare | Mesatare historike | | 9.2% | Dec-18 | -0.2 pp | 0.1 pp |
| | Sipas industrisë dhe valutës | Pesha e kredisë për tregti dhe riparim automjesh | Mesatare historike | | 34.8% | Dec-18 | -0.6 pp | 1.9 pp |
| | | Pesha e kredisë për industrinë e ndërtimit | Mesatare historike | | 14.1% | Dec-18 | 1.2 pp | 1.4 pp |
| | | Pesha e kredisë për energjinë elektrike gaz dhe ajër të kondicionuar | Mesatare historike | | 9.7% | Dec-18 | -0.5 pp | -4.8 pp |
| | | Pesha e kredisë për industrinë përpunuese | Mesatare historike | | 14.5% | Dec-18 | -0.9 pp | -0.3 pp |
| | | Ndryshimi vjetor i kredisë për tregti dhe riparim të automjeshve | Mesatare historike | | -1.8% | Dec-18 | -1.9 pp | 3.0 pp |
| | | Ndryshimi vjetor i kredisë për industrinë e ndërtimit | Mesatare historike | | 3.1% | Dec-18 | 6.3 pp | 4.4 pp |
| | | Ndryshimi vjetor i kredisë për energji gaz dhe ajër të kondicionuar | Mesatare historike | | -37.8% | Dec-18 | -6.4 pp | -45.4 pp |
| | | Ndryshimi vjetor i kredisë për industrinë përpunuese | Mesatare historike | | -9.2% | Dec-18 | 1.7 pp | 0.0 pp |
| | | Kredi në valutë ndaj totalit të portofolit | Literatura, në nivelin 36% | | 56.1% | Dec-18 | -0.4 pp | -0.4 pp |
| | | Kredi në valutë të pambrojtura nga kursi ndaj totalit të portofolit | Gjykimi i ekspertëve, në nivelin 0% | | 24.3% | Dec-18 | 0.0 pp | -0.3 pp |
| Indekse | Standardet e kredidhënies për biznese | Mesatare historike | | 0.0 | Dec-18 | 16.6 pk | 0.2 pk | |
| | Standardet e kredidhënies për individë | Mesatare historike | | 15.9 | Dec-18 | 8.5 pk | 15.9 pk | |
| | Indeksi i kostos relative të banimit | Mesatare historike | | 92.9 | Dec-18 | 30.8 pk | 24.5 pk | |
| | Indeksi i çmimit të banesave | Mesatare historike | | 162.4 | Dec-18 | 5.1 pk | -12.0 pk | |
| | Indeksi i qirasë së banesave | Mesatare historike | | 73.5 | Dec-18 | 0.9 pk | -0.7 pk | |
| Raporti i çmimit të banesave ndaj qirasë | Mesatare historike | | 2.2 | Dec-18 | 0.0 pk | -0.1 pk | | |

Qasja "përgjatë ciklit" ofron një vështrim afatgjatë të zhvillimit të tregusit (treguesve) të përzgjedhur, duke lejuar një vlerësim më të mirë të ndryshimeve ciklike dhe strukturore të aktiviteteve bankare dhe ekonomike, si edhe të nevojës për përgjigjen e politikës makroprudenciale.

Ndryshimi i klimës duket si një sfidë më e largët për industrinë financiare në Shqipëri. Megjithatë, vendi ka përjetuar situata të lidhura me ngjarjet klimatike, siç janë përmytjet dhe thatësitat, që mundësojnë një informacion paraprak se sa mund të jetë shkalla e ndikimit nëse ngjarje të tilla shpeshohen dhe rëndohen në të ardhmen. Megjithëse ekspozimi pritet të jetë më i madh në industrinë e sigurimeve, segmente të tjera të sistemit financiar (dhe agjentët e ekonomisë) nuk janë të imunizuar. Ekziston një mundësi e madhe që në situata ekstreme, ngjarjet negative klimatike mund të sjellin shkatërrime në ekonomi dhe të prodhojnë stres të konsiderueshëm, deri në shqetësime sistemike, për industrinë financiare.

Banka e Shqipërisë synon t'i kushtojë më tepër vëmendje këtyre çështjeve. Aktualisht, po komunikojmë me industrinë bankare dhe po monitorojmë zhvillimet në lidhje me shkallën e përshtatjes së shërbimeve *Fintech*. Megjithëse, deri më tani nuk kemi hasur sfida specifike nga ky proces, jemi të vetëdijshëm se procesi ka potencial të zhvillohet me shpejtësi dhe kërkon një nivel të mjaftueshëm njohurie, fleksibiliteti dhe aftësie për t'u administruar në mënyrë efektive. Mundësitë dhe rreziqet që burojnë nga *Fintech* dhe nga ndryshimet klimatike mund të administrohen në mënyrë të përshtatshme vetëm përmes bashkëpunimit efektiv të të gjithë rregullatorëve. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë mbështet iniciativat për të përmirësuar bashkëpunimin me AMF-në dhe Qeverinë e Republikës së Shqipërisë mbi këto tema.

V. Zbatimi i politikës makroprudenciale në Shqipëri

Kur vjen puna te zbatimi i PMP-së, Banka e Shqipërisë fokusohet mbi: a) të kuptuarit e politikës monetare dhe përcaktimin e rolit të Bankës së Shqipërisë në këtë fushë të politikës; b) përforcimin e kornizës për vlerësimin e rrezikut sistemik; c) ndërtimin e kornizës për përshtatjen e instrumenteve/mjeteve të PMP-së; d) zhvillimin e kapaciteteve për vlerësimin e ndikimit të instrumenteve të PMP-së që mund të përdoren.

5.1 Strategjia e Politikës Makroprudenciale

Dokumenti i Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për politikën makroprudenciale⁸ (Strategjia), miratuar në muajin gusht 2017, ofron një kornizë të përgjithshme operationale për zbatimin e politikës makroprudenciale. Më specifikisht, Strategjia synon:

- a) të krijojë lidhje mes objektivit përfundimtar të PMP-së dhe objektivave të ndërmjetëm dhe instrumenteve makroprudencial;
- b) të themelojë një kornizë të shëndetshme për zbatimin e instrumenteve makroprudencial, duke përfshirë treguesit për monitorimin e ecurisë së rrezikut sistemik dhe për udhëzimin e vendimeve të lidhura me zbatimin, rikalibrimin ose çaktivizimin e instrumenteve makroprudencial;
- c) të shpjegojë procesin e vendimmarrjes, si edhe procesin komunikimit ndërinstitucional dhe publik në Bankën e Shqipërisë, në lidhje me zbatimin e politikës makroprudenciale.

⁸ https://www.bankofalbania.org/Financial_Stability/Macro-prudential_policies/Macro-prudential_strategy/

5.2 Objektivat e ndërmjetëm dhe instrumentet e politikës

Instrumentet makroprudenciale që përdoren për të adresuar spektrin e përgjithshëm të rrezikut sistematik, mund të ndahen në dy grupe:

- a) *Instrumentet e kapitalit dhe të likuiditetit*, që operojnë duke përmirësuar rezistencën e bilancit të bankës, në rastin e kërkesave strukturore të kapitalit, dhe duke ndihmuar për të ruajtur ofertën e kredisë bankare në kushte ekonomike të pafavorshme, në rast të kërkesave kundërciklike. Shtesa kundërciklike e kapitalit dhe instrumentet për zgjerimin e stokut të aktiveve likuide, si kërkesa për Raportin e Mbulimit me Likuiditet, janë shembuj të këtyre instrumenteve;
- b) *Instrumentet e tjera*, që kryesisht operojnë duke përmirësuar rezistencën e huamarrëve, tipikisht të individëve. Këtu përfshihen shembuj të kufijve të kredisë, si niveli maksimal i raportit “vlera e huasë/vlera e kolateralit” (*LTV*), i raportit “shërbimi i borxhit/të ardhurat” (*DSTI*) ose i raportit “vlera e huasë/të ardhurat” (*LTI*), të cilat synojnë të përforcojnë stabilitetin e huamarrëve përkundrejt goditjeve të pafavorshme në çmimin e aktiveve dhe të ardhurat, dhe të ndikojnë pozitivisht në mënyrë indirekte ndaj stabilitetit të bankave, përmes disiplinës së përmirësuar në shlyerje.

Banka e Shqipërisë ka nën kontrollin e saj direkt një ose më shumë instrumente për çdo objektivi të ndërmjetëm të PMP-së për sektorin bankar, të identifikuar në përputhje me Rekomandimin BERRS/2013/1. Tabela tregon një listë të pashteruar dhe të ndryshueshme të instrumenteve që mund të përdoren, kanalet e tyre të transmetimit dhe mënyrën se si ato i janë caktuar objektivave të ndryshme të ndërmjetëm.

Tabëlë 4: Instrumentet makroprudencialë për të arritur objektivat e ndërmjetëm

| Objektivat e ndërmjetëm | Instrumentet⁹ | Kanalet e transmetimit |
|--|---|---|
| <i>Zbutja dhe parandalimi i rritjes së tepërt të kreditimit dhe huamarrjes</i> | <p>Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC)</p> <p>Ndryshimet e koeficientit të rrezikut për aktivet e ponderuara me rrezik</p> <p>Kufijtë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - raportin “vlera e huasë/vlera e kolateralit” (<i>LTV</i>); | <p>Rrit rezistencën e bankave; mund të ulë normën e rritjes së kreditimit për shkak të kostove financiare më të larta, në varësi të fazës së ciklit financiar;</p> <p>Kufizon rritjen e tepërt të kreditimit (të përgjithshëm dhe sektorial), duke parandaluar rreziqet; rrit kapacitetin e bankave për të përthithur humbje.</p> <p>Vendos kufij direk për huamarrjen; forcon rezistencën e huamarrëve (ul probabilitetin e falimentimit - <i>LTI</i>, <i>DSTI</i>) dhe të bankave (ul humbjet në rast falimentimin,</p> |

⁹ Me ngjyrë të theksuar të zezë janë treguar instrumentet për të cilat Banka e Shqipërisë ka përgatitur kornizën rregullatore, ose i ka zbatuar brenda datës së botimit të këtij dokumenti.

| | | |
|---|---|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - raportin "vlera e huasë/të ardhurat" (<i>LTI</i>); - raportin "shërbimi i borxhit/të ardhurat" (<i>DSTI</i>); <p>Imponimi i shtesave të kapitalit për rrezikun sistemik</p> <p>Imponimi i raportit të levës financiare</p> | <p>LTV), zbut natyrën prociklike të kreditimit për pronat e paluajtshme (LTV); zbut rritjen e shpejtë të kredisë së konsumatorit (DSTI), për shembull huatë për automjete ose ato të financuara me kartë krediti;</p> <p>Rrit kapacitetin e bankës për të përthitur humbjet; mund të ndikojë prirjen e ciklit financiar përmes rritjes së kostove të financimit;</p> <p>Kufizon huamarrjen e paqëndrueshme të bankave; vepron si mekanizëm sigurimi kundrejt kompleksitetit të vlerësimit të aktiveve të ponderuara me rrezik.</p> |
| <p>Zbutja dhe parandalimi i diferencave në afatet e maturimit dhe i mungesës së likuiditetit në treg.</p> | <p>Ndryshimi i normës së rezervës së detyruar¹⁰</p> <p>Ndryshimi në minimumin e nivelit të aktiveve likuide dhe në përbërjen e tyre;</p> <p>Kufijtë në raportin "kredi/depozitë"; Përdorimi i raportit "të mbulimit me likuiditet" (LCR) dhe i raportit "neto të financimit të qëndrueshëm" (<i>NSFR</i>)</p> | <p>Rrit rezistencën e bankave dhe përmirëson përbërjen e aktiveve likuide, duke përfshirë valutën;</p> <p>Kufizon hendekun e afatet e ponderuara të maturimit (<i>duration</i>); kufizon përdorimin e formave të paqëndrueshme të financimit;</p> <p>Përforcon strukturën e financimit të bankave, përkundrejt flukseve të stresuara dalëse; mund të ndikojnë ciklin financiar nëse kërkesat shkaktojnë nevojën për të lëvizur drejt aktiveve likuide.</p> |
| <p>Kufizimi i përqendrimeve të ekspozimit direkt dhe të tërthortë</p> | <p>Shtesa e kapitalit për rrezikun sistemik (STRUK) [i pranishëm në</p> | <p>Rrit aftësinë e bankave për të përthitur humbjet; rrit kostot e</p> |

¹⁰ Norma e rezervës së detyruar është një instrument që përdoret tradicionalisht për qëllimet e politikës monetare. Për shkak të ndikimit që ka në rritjen e rrezikut të likuiditetit dhe përmirësimit të rezistencës së sektorit bankar, në këtë rast, përfshihet si një instrument i politikës makroprudenciale.

| | | |
|---|---|---|
| | kornizën rregullatore por i paaktivuar aktualisht] | financimit dhe kufizon përqëndrimet. Rrit rezistencën e bankave kundrejt rrezikut (përforon kapacitetin e tyre për t'i bërë ballë humbjeve). |
| | Imponimi i kufijve ose kërkesave të kapitalit për ekspozimet e mëdha (nga kundërpalët, sektori, valuta, vendndodhja gjeografike) | |
| <i>Kufizimi i rreziqeve të tepërta nga institucionet financiare me rëndësi sistemike.</i> | Imponimi i shtesave të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike; imponimi i kërkesave më specifike për rrezikun e likuiditetit | Ul probabilitetin dhe madhësinë e ndikimit të dështimit të bankave me rëndësi sistemike; përforon rezistencën e bankave. |

Numri i gjerë i instrumenteve mundëson që ato të përdoren paraprakisht dhe specifikisht, të vetme ose të kombinuara, për të realizuar çdo objektiv të veçantë.

Nëse nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit në Bankën e Shqipërisë identifikohet një rrezik material sistematik që mund të ndikohë negativisht në stabilitetin financiar, Banka e Shqipërisë ndërmerr veprime politike (përdor instrumente makroprudenciale) për të zbutur rrezikun ose për të rritur rezistencën kundra tij. Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit vijojnë edhe për të vlerësuar efektivitetin e instrumenteve të politikës dhe për të identifikuar nëse ata kanë sjelle ndikime të padëshirueshme. Kur është e nevojshme, bëhen ndryshime në politikë për të përmirësuar rezultatet e saj. Ky proces i vazhdueshëm monitorimi është gjithashtu i nevojshëm për të identifikuar rreziqe dhe dobësi që dalin rishtazi.

5.3 Instrumentet makroprudenciale të zbatuar nga Banka e Shqipërisë dhe puna e së ardhmes

Rregullorja nr. 41/2019 "Për shtesat makroprudenciale të kapitali"¹¹ prezantoi në kornizën rregullatore shqiptare Shtesën Konservuese të Kapitalit (KONS), Shtesën Kundërciklike të Kapitalit (KUNC), shtesën e kapitalit për bankat sistemike (SIST) dhe shtesën e Kapitalit për Rrezikun Sistemik (STRUK). Të gjitha këto shtesa mbahen në instrumentet e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë (KBN1), zbatohen si "shtesa" ndaj kërkesave të detyrueshme të kapitalit, posaçërisht të kërkesave "Shtylla 1 + Shtylla 2 + MREL", dhe shprehen në përqindje ndaj Ekspozimeve të Ponderuara me Rrezik.

Banka e Shqipërisë ka nisur të zbatojë shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas rregullores dhe ka botuar metodologjitë për zbatimin e shtesës kundërciklike të kapitalit¹² dhe të shtesës së kapitalit për bankat sistemike¹³.

¹¹ https://www.bankofalbania.org/Financial_Stability/Macro-prudential_policies/Instruments_of_Macroprudential_Policy/test/

¹² E njëjta adresë elektronike si më sipër.

¹³ E njëjta adresë elektronike si më sipër.

Me përjashtim të nivelit të KONS që përcaktohet nga rregullorja¹⁴, të gjitha shtesat e tjera shpallen me vendim të Guvernatorit. Niveli i shtesave duhet të plotësohet jo më vonë se 6-12 muaj nga data e shpalljes kur shtohen, ose jo më vonë se 6 muaj (duke përfshirë menjëherë) kur pakësohen. Duke filluar nga fundi i qershorit 2019, Guvernatori ka lëshuar vendime tremujore për KUNC¹⁵. Bankat raportuan zyrtarisht, për herë të parë, në muajin mars 2020 për shkallën e plotësimin të shtesave të makroprudenciale të kapitalit. Rregullorja parashikon se nivelet maksimale të shtesave të kapitalit siç janë përcaktuar në rregullore, do të arrihen¹⁶ duke filluar të paktën nga muaji janar 2024.

Rregullorja e përcakton konceptin e shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit si raportin mes kapitalit të disponueshëm neto dhe kërkesës së shtesës së kombinuar. Ky raport duhet të ketë një vlerë prej të paktën 100%. Bankat e raportojnë këtë tregues në Bankën e Shqipërisë çdo tremujor në fund të marsit, qershorit, shtatorit dhe dhjetorit.

Gjithashtu, rregullorja përcakton marrëdhënien mes shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit dhe pagesës së shpërndarjes dhe çfarë ndodh kur, për shkak të kësaj të fundit banka është në rrezik të mosplotësimin të raportit të shtesës së kombinuar ose të thellimit të hendekut. Në situata të tilla, banka duhet të konsultojë paraprakisht Bankën e Shqipërisë, të paraqesë informacionet e kërkuara dhe të paraqesë një plan për rimëkëmbjen e pozicionit të kapitalit. Banka e Shqipërisë ruan të drejtën për të shfuqizuar çdo vendim të bankës dhe për të refuzuar tërësisht pagesën e shpërndarjes.

5.3.1 Zbatimi i shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC)

Shtesa KUNC synon të ruajë ritmet e qëndrueshme të kreditimit për ekonominë duke e bërë sistemin bankar më pak prociklik dhe më shumë rezistent. Për këtë, KUNC duhet të ngrihet në një kohë kur ka rritje të tepërt të kreditimit, për të ulur sjelljen prociklike të bankave, dhe të çlirohet në një kohë stresi, për t'i lejuar bankat të përdorin shtesat në mënyrë që të përthithin humbjet dhe, në të njëjtën kohë, të ulin rrezikun e ngërcit të kredisë.

Rregullorja kërkon që KUNC të përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, mbështetur në treguesit e përzgjedhur, të cilët reflektojnë drejtë ciklin e kredisë në Shqipëri dhe përfshijnë, pa kufizime, "raportin e kredisë ndaj hendekut të PBB-së" si treguesin kryesor të referencës (udhëzues). KUNC duhet normalisht të ketë një vlerë nga 0-2.5% (me përjashtim të rasteve kur një shifër më e lartë justifikohet nga Banka e Shqipërisë), dhe niveli i KUNC duhet të rivlerësohet çdo tremujor. Rregullorja përcakton gjithashtu mënyrën se si llogaritet KUNC në nivel institucional: çdo bankë duhet të identifikojë ekspozimet përkatëse të kredisë në Shqipëri dhe në juridiksionet e huaja, dhe të aplikojë raportin e KUNC në të gjitha këto juridiksione. Normalisht, raporti KUNC për një juridiksion të veçantë shpallet nga autoriteti makroprudencial i atij juridiksioni, megjithatë në rastin

¹⁴ Rregullorja përcakton nivelet e KONS për periudhën 2020-2024. Fillon me 0.5% nga muaji mars 2020, dhe më pas, rritet çdo vit me 0.5%, duhet të arrijë 2.5% nga 1 janari 2024. Niveli i shtesave duhet të përmbushet jo më vonë se 6-12 muaj nga data e shpalljes.

¹⁵ Të gjitha vendimet e Guvernatorit botohen në faqen online të Bankës së Shqipërisë, së bashku me arsyetimet përkatëse.

¹⁶ Ky është rasti i KONS, teksa niveli maksimal i KUNC dhe i shtesave të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike, varen nga prirjet e ciklit financiar dhe shenjat e bankës për rëndësinë sistemike.

e rreziqeve akute që shfaqen nga ekspozimet në atë juridiksion të huaj, Banka e Shqipërisë, në kushte të veçanta, ka të drejtën të zbatojë një KUNC më të lartë.

Siç kërkohet nga rregullorja, Banka e Shqipërisë përgatit metodologjinë e zbatimit të KUNC. Kjo metodologji përshkruan me hollësi përlllogaritjen e “hendekut kredi ndaj PBB” si treguesi kryesor udhëzues, kontributin e “treguesit plotësues të paralajmërimit të hershëm” si udhëzuesi i dytë plotësues, të tjera të dhëna që mbështesin gjykimin e ekspertëve në lidhje me kalibrimin e KUNC, si edhe çështje të tjera në lidhje me komunikimin e KUNC. Kjo metodologji botohet në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë¹⁷.

5.3.2 Zbatimi i shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST)

Shtesa SIST synon të parandalojë shtimin e rrezikut sistematik që buron nga veprimtaria e pakujdesshme të lidhura me një institucion që konsiderohet si “shumë i madh për të dështuar”. Kjo zbatohet vetëm për bankat me kryesore, siç janë identifikuar bazuar në faktorët që përfshijnë madhësinë, ndërlidhshmërinë, zëvendësueshmërinë dhe kompleksitetin.

Kur klasifikohen bankat me rëndësi sistemike, Banka e Shqipërisë përdor 5 shporta: për bankat që janë pjesë e shportës së parë shtesa SIST është 0.5% (me rritje lineare me të njëjtin hap dhe me një fazë tranzitore që përfundon në vitin 2023), ndërsa bankat që janë pjesë e shportës së pestë (të hapur) shtesa SIST mund të arrijë deri në 3% (duke filluar nga 1 janar 2024).

Siç e kërkon rregullorja, Banka e Shqipërisë zhvilloi metodologjinë për përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike dhe shtesave përkatëse SIST, dhe e botoi në faqen e internetit¹⁸. Metodologjia përcakton faktorët që merren në konsideratë për identifikimin e bankave sistemike dhe përshkruan llogaritjen e Notës së Rëndësisë Sistemike (NRS) të bankës. Shpërndarja e NRS-ve e lejon llogaritjen e pragut të saj sistematik dhe të vlerave kufi për secilën nga 5 shportat. Së fundi, spektri i shtesave SIST (nga 0.5% deri në 3%) është i ndarë sipas secilës prej 5 shportave.

Përcaktimi i bankave me rëndësi sistemike dhe shtesave përkatëse SIST bëhet një herë në vit, gjatë tremujorit të parë.

5.3.3 Zbatimi i shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik (STRUK)

Rregullorja përcakton fushën e zbatimit dhe qëllimin e STRUK. Duke qenë se përvoja ndërkombëtare me shtesën e kapitalit për rrezikun sistematik është ende e kufizuar, rregullorja ka një qasje fleksibël për përdorimin e mundshëm të kësaj shtese, megjithëse ruan fushën e zbatimit të saj për rreziqet strukturore sistemike. STRUK është e zbatueshme për një pjesë ose të gjithë listën e bankave, për një pjesë ose të gjithë ekspozimet vendore ose të huaja të bankave, në të njëjtin ose në nivele të ndryshme në banka. Për bankat me rëndësi sistemike, STRUK zbatohet nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se rreziqet strukturore nuk janë përballur si duhet me shtesat SIST. Kur STRUK zbatohet në bankat me rëndësi sistemike, sasia e “SIST+STRUK” nuk duhet të tejkalojë 4% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik. STRUK duhet të ketë një nivel minimal prej 1% dhe të

¹⁷ https://www.bankofalbania.org/Financial_Stability/Macro-prudential_policies/Instruments_of_Macroprudential_Policy/test/

¹⁸ E njëjta adresë elektronike si më sipër.

rritet me shumëfisha të 0.5% duke arritur një nivel maksimal prej 3%, jo më herët se data 1 janar 2024. SRUK normalisht shpallet gjatë tremujorit të parë të vitit, dhe rishqyrtohet të paktën çdo dy vite.

Banka e Shqipërisë është aktualisht duke punuar për të detajuar mënyrën e zbatimit të STRUK.

5.3.4 Raporti i Mbulimit me Likuiditet (RML)

Rregullorja nr. 27 e datës 28 mars 2019 “Për raportin e mbulimit me likuiditet” (RML) parashikon kornizën rregullatore të RML-së që zbatohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. RML-ja është caktuar në vlerën minimale 100% në total dhe në vlerën minimale 80% për të gjitha valutat e rëndësishme¹⁹. Raporti përfaqëson raportin e shtesës së likuiditetit (Aktive të Nivelit 1 plus të Nivelit 2) ndaj likuiditetit hyrës neto, gjatë një periudhe stresi prej 30 ditësh. Bankave iu kërkohet të caktojnë kufij të brendshëm për RML-në në politikat dhe procedurat e tyre për lekun dhe në çdo valutë të huaj të rëndësishme, si edhe të raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo muaj për qëllime monitorimi.

Mbi baza individuale, bankat duhet të përmbushin nivelin minimal të RML-së duke filluar nga 1 mars 2020, duke lejuar një periudhë tranzitore përtej kësaj date për treguesin e totalit të valutave. Në një bazë të konsoliduar, bankat duhet të pajtohen me nivelin minimal të RML-së (në total dhe për valutat) nga 1 janar 2022.

5.4 Kombinimi i instrumenteve të ndryshme makroprudenciale

Brenda politikës makroprudenciale, kombinimi i instrumenteve të ndryshme makroprudencialë për të arritur një objektiv të caktuar mund të jetë i dobishëm përse i përket efektivitetit dhe efektshmërisë. Kjo mund të përmirësojë fushën e zbatimit të politikës makroprudenciale dhe të përshpejtojë ndikimin e instrumenteve të zbatuar, për shembull duke zvogëluar mundësinë e shmangies së subjekteve. Nga ana tjetër, nëse kombinimi i instrumenteve të ndryshëm makroprudencialë nuk merret parasysh ashtu si duhet, mund të shkaktojë ndikim të tepruar dhe/ose ndikime të tjera të padëshiruara.

Për ta shmangur këtë, nevojitet që të bëhet një lidhjet e kujdesshme mes objektivit dhe instrumenteve përkatës, të kuptohen sakte kanalet e transmetimit të masave të përzgjedhura, të sigurohet kalibrimi i përshtatshëm i instrumenteve dhe t’i kushtohet vëmendje kohës së duhur të zbatimit. Sjellja e tregut ka nevojë të orientohet përmes komunikimit të mirë rreth mënyrës së zbatimit dhe pritjeve për instrumentet, ndërkohë që është e nevojshme vendosja e një sistemi të përshtatshëm monitorimi. Së fundi, rregullat e zbatimit të instrumentit duhet të mbështesin mekanizma të shpejta apo automatikë korrektimi, që ulin probabilitetin ose shkallën e ndikimit të padëshiruar dhe lejojnë korrigjime në kohën e duhur.

¹⁹ Valuta e rëndësishme është ajo ku detyrimet në atë valutë përfaqësojnë më tepër se 5% të detyrimeve totale të bankës.

5.5 Puna e së ardhmes

Banka e Shqipërisë synon të punojë në zgjerimin dhe përmirësimin e paketës makroprudenciale, paralelisht me tregun financiar dhe zhvillimet e formave të rrezikut. Në këtë aspekt, operacionalizimi i STRUK dhe ngritja e konrizës rregullatore për përdorimin e instrumenteve të bazuar tek huamarrësit siç janë kufijtë për *LTV* dhe *DTI*, janë fokusi ynë në periudhën afatshkurtër.

Përsa i përket STRUK, Banka e Shqipërisë do marrë në konsideratë ndryshimet e fundit të prezantuara si pjesë e paketës legjislative *CRD V* dhe do punojë për ndryshimet e Rregullores 41/2019 për të rritur fleksibilitetin në përdorimin e STRUK. Nëse është e nevojshme, do të miratohet një metodologji e veçante për zbatimin e kësaj shtese.

Referuar masave të bazuara tek huadhëmarrësit, Banka e Shqipërisë synon të ndërtojë një kornizë bazë rregullatore që do të lejonte përdorimin e tyre në rast nevoje. Rrjedhimisht, rreziqet e mundshme që burojnë nga ndërveprimi mes sektorit financiar dhe zhvillimeve në tregjet e pronave të paluajtshme, do të adresoheshin më mirë. Si një hap parapërgatitor, Banka e Shqipërisë ka filluar të grumbullojë të dhëna për praktikën e bankës në lidhje me përdorimin aktual të këtyre instrumenteve. Ky informacion do të ndihmojë me përcaktimin e kufijve dhe pragjeve, kur këto instrumente të vendosen, eventualisht, në zbatim.

5.6 Ndërveprimi i politikave në Bankën e Shqipërisë

Kur instrumentet kombinohen për të adresuar objektivat e ndryshme që i përkasin politikave të ndryshme ekonomike, duhet t'i kushtohet vëmendje mënyrës se si këto politika ndërveprojnë në fazat e ndryshme të ciklit financiar/ekonomik. Në Bankën e Shqipërisë, janë vendosur procedura për të siguruar bashkëpunimin mes politikave të ndryshme.

Ndërveprimi mes politikës makroprudenciale dhe politikës monetare është i pashmangshëm, i nevojshëm dhe ndodh gjatë gjitha kohës. Në Bankën e Shqipërisë, ky ndërveprim lehtësohet nga pjesëmarrja e përfaqësuesve të çdo departamenti në Komitetin Këshillimor të Politikës Monetare si edhe në Komitetin Këshillimor të Stabilitetit Financiar. Kjo ka për qëllim që vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për fushat përkatëse të politikës të jetë sa më e informuar, mbështetur në shkëmbimin e rregullt dhe në kohën e duhur të informacionit përkatës për mënyrën se si mund të ndërveprojnë politikat në arritjen e synimeve të Bankës së Shqipërisë. Bashkëpunimi mes Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe departamenteve të Politikës Monetare dhe të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, ndodh gjithashtu në mënyrë të rregullt gjatë ushtrimit të provës së rezistencës. Zakonisht, departamentet e Politikës Monetare dhe të Kërkimeve kanë ekspertizë të lartë për zhvillimin e skenarëve përkatës makroekonomikë, mbështetur në aftësi modeluese të avancuara. Me anë të modeleve specifike, këto skenarë përdoren nga Departamenti i Stabilitetit Financiar që i përkthen ato në goditje ndaj aktivitetit të sektorit bankar, me qëllim që të vlerësojë rezistencën e këtij të fundit.

Ndërveprimi dhe bashkërendimi me mbikëqyrjen mikroprudenciale, ndodh si pjesë e veprimtarisë së Komitetit Këshillimor të Stabilitetit Financiar ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përfaqësues të të dyja departamenteve marrin pjesë në grupe pune të përbashkëta që formohen për të kryer analiza

specifike ose për të zhvilluar veprime rregullatore. Opinionet kërkohen dhe shkëmbehen në mënyrë të rregullt rreth temave që kanë një interes të përbashkët dhe aktual për objektivat e stabilitetit financiar. Aksesit të dhëna apo informacione të ngjashme, i kushtohet vëmendje e veçantë dhe ky akses është aktualisht i siguar. Shembuj të bashkëpunimit të ngushtë mes dy fushave përfshijnë masat që ndikojnë pozicionin e kapitalit të bankës dhe ndërveprimin mes kërkesave për kapitalin rregullator dhe shtesave makroprudenciale të kapitalit.

Banka e Shqipërisë është autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme që operon në vend, dhe një departament specifik në institucion është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e kësaj kornize. Bashkëpunimi me funksionin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme lehtësohet nga fakti që departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është gjithashtu anëtar i Komitetit Këshillimor të Stabilitetit Financiar. Gjithashtu, ekzistojnë grupe pune të përbashkëta dhe të përhershme mes departamenteve të Mbikëqyrjes, Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Stabilitetit Financiar që mundësojnë zgjidhje për çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha palët.

Ndërveprimi i politikës makroprudenciale me politikën fiskale është i zakonshëm në disa drejtime që përfshijnë aksesin në të dhënat shtetërore që janë të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut sistemik dhe gjithashtu që ndihmojnë në përfundimin e efektivitetit të instrumenteve të politikës makroprudenciale nëpërmjet masave plotësuese të agjencive shtetërore. Gjithashtu, vendimet e politikës fiskale mund të ndikojnë objektivat dhe instrumentet makroprudencialë, dhe diskutimi paraprak i tyre është i nevojshëm dhe i rëndësishëm. Duke mbajtur këtë në mendje, një platformë për bashkëpunimin midis politikave funksionon nën ombrellën e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar. Aktualisht, zbatimi i Strategjisë së deuroizimit është një shembull ku ky bashkëpunim është i rëndësishëm.

VI. Komunikimi dhe llogaridhënia

Komunikimi në fushën e PMP-së (komunikimi makroprudencial) njofton publikun për punën e Bankës së Shqipërisë në këtë aspekt dhe përfaqëson një kontribut të rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit financiar, duke patur fuqinë për të ndikuar sjelljen e pjesëmarrësve në treg dhe për të përmirësuar disiplinën e tij. Me anë të komunikimit të PMP-së, Banka e Shqipërisë plotëson detyrimin për llogaridhënie në lidhje me ushtrimin e fuqive makroprudenciale dhe kontribuon në ndërgjegjësimin e publikut rreth rreziqeve financiare sistemike.

Komunikimi makroprudencial mbulon të paktën këto elementë: a) organizimi i PMP-s; b) monitorimi i rrezikut sistemik dhe c) zbatimi i politikës makroprudenciale.

Tabelë 5: Komunikimi publik i PMP

| Organizimi i PMP | Monitorimi i rrezikut sistemik | Masat makroprudenciale |
|-----------------------------|--|----------------------------------|
| Mandati | Rreziqet e identifikuara dhe vlerësimi i rëndësisë së tyre | Lloji i secilës masë |
| Objektivat | Treguesit | Nevoja dhe niveli i secilës masë |
| Procesi i vendimmarrjes | | Fusha e zbatimit |
| Instrumentet e disponueshëm | | Data e zbatimit |

Banka e Shqipërisë ka për synim ta informojë rregullisht publikun rreth aktiviteteve të saj në kornizën e stabilitetit financiar dhe të politikës makroprudenciale. Informacioni ofrohet në botimet e: Raportit të Stabilitetit Financiar dhe raporteve të tjera periodike; raportimit të Guvernatorit përpara Kuvendit dhe komunikime të tjera zyrtare; vlerësimeve të posaçme për prirjet e rrezikut sistemik në sistemin financiar; dokumenteve metodologjike për përdorimin e instrumenteve të politikës makroprudenciale për zbutjen e rreziqeve sistemike; deklaratave për shtyp; fjalimeve ose prezantimeve të përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë. Platforma kryesore e komunikimit makroprudencial është faqja e internetit e Bankës së Shqipërisë²⁰.

Në komunikimet për PMP-në, si edhe për politikat e tjera që ndjek, Banka e Shqipërisë e ruan në çdo rast besueshmërinë e saj. Për të arritur këtë qëllim, dhe duke marrë parasysh përparësinë e ruajtjes së stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë bën çdo përpjekje për të garantuar se komunikimi makroprudencial është sa më i hapur, i qartë, i arsyeshëm dhe në kohën e duhur, mbështetur në informacionin më të plotë të mundshëm. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë është e vetëdijshme për nevojën e shmangies së publikimit të parakohshëm të informacionit sensitiv, i cili mund të vendosë në rrezik stabilitetin financiar.

²⁰ [https://www.bankofalbania.org/Financial Stability/Macro-prudential policies/](https://www.bankofalbania.org/Financial%20Stability/Macro-prudential%20policies/)